



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT TË BURIMEVE
NATYRORE
DREJTORIA MINERARE DHE INDUSTRIALE

URDHËR

Nr. 311, datë 13.9.2011

PËR

**MIRATIMIN E FORMËS SË INFORMACIONEVE TREMUJORE, VJETORE,
PËRFUNDIMTARE DHE PËRMBAJTJEN E PLANIT VJETOR TË PUNËS NGA
ZOTËRUESIT E LEJEVE MINERARE TË KËRKIMIT-ZBULIMIT –SHFRYTËZIMIT
PËR GRUPIN E MINERALEVE TË ÇMUARA DHE GJYSËM TË ÇMUARA**

Në zbatim të nenit 102 pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 27 pika 2 dhe nenit 56 pika 2, të Ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”;

URDHËROJ :

1. Formati i informacionit tremujor, për veprimtarinë minerare të realizuar nga zotëruesi i lejes minerare të kërkimit-zbulimit–shfrytëzimit për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysëm të çmuara duhet të jetë në përputhje me formatin e përshkruar në aneksin 1 të këtij urdhëri. Ky informacion duhet të dorëzohet pranë institucionit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) jo më vonë se data 15 e muajit që vijon, për çdo tremujor. Mosdorëzimi në afat i këtij informacioni dënohet me masën administrative gjobë prej 100 000 (njëqind mijë) lekë për çdo shkelje, në përputhje me nenin 45, pika 1. ç), të Ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”
2. Formati i informacionit vjetor, për veprimtarinë minerare të realizuar nga zotëruesi i lejes minerare të kërkimit-zbulimit–shfrytëzimit për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysëm të çmuara duhet të jetë në përputhje me formatin e përshkruar në aneksin 2, të këtij urdhëri. Ky informacion duhet të dorëzohet pranë institucionit të AKBN çdo vit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga përfundimi i vitit përkatës. Mosdorëzimi në afat i këtij informacioni dënohet me masën administrative gjobë prej 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë për çdo


- shkelje në përputhje me nenin 45, pika 1. d), të Ligjit Nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”.
3. Formatit dhe përmbajtja e planit vjetor të punës, të parashikuar për t’u realizuar gjatë veprimtarisë minerare të vitit në vazhdim, të përcaktuar në përputhje me datën efektive të dhënies së lejes, nga zotëruesi i lejes minerare të kërkimit-zbulimit –shfrytëzimit për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysëm të çmuara, duhet të jetë në përputhje me planin e zhvillimit të veprimtarisë minerare të miratuar në lejen e tyre minerare dhe sipas formatit të përshkruar në aneksin 3 të këtij urdhëri. Ky plan duhet të dorëzohet pranë institucionit të AKBN jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike përpara përfundimit të vitit, llogaritur nga data e hyrjes në fuqi të lejes për çdo vit. Mosdorëzimi në afat i këtij informacioni dënohet me masën administrative gjobë 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë për çdo shkelje në përputhje me nenin 45, pika 1. dh), të Ligjit Nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”.
 4. Subjektet minerare, të cilët përmbajtjen e planit vjetor të punës nuk e kanë realizuar në përputhje me pikën 3 të këtij urdhëri, kanë të drejtë që brenda periudhës së përcaktuar në pikën 3 të këtij urdhëri të bëjnë përmirësimin e tij.
 5. Subjektet minerare, të pajisura me leje minerare të kërkimit-zbulimit–shfrytëzimit për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysëm të çmuara duhet që në përfundim të afatit të lejes, apo përfundimit të saj përpara këtij afati të përgatisin raportin përfundimtar për zhvillimin e veprimtarisë minerare që duhet të jetë në përputhje me formatin e përshkruar në aneksin 4 të këtij urdhëri. Në raport të përshkruhen në mënyrë të detajuar investimet e realizuara gjatë shfrytëzimit, punimet minerare të kryera në zonën e tij të lejuar, shoqëruar me vizatimet inxhinierike. Mosdorëzimi i këtij informacioni dënohet me masën administrative gjobë 300 000 (treqind mijë) lekë në përputhje me nenin 45, pika 1. ë), të Ligjit Nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”.
 6. Subjektet minerare të pajisura me leje minerare të kërkimit-zbulimit –shfrytëzimit për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysëm të çmuara duhet të realizojnë planin e mbylljes të veprimtarisë minerare dhe planin e rehabilitimit përfundimtar të zonës e tyre të lejuar në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”.
 7. Institucioni i AKBN jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të çdo tremujori duhet të dorëzojë në METE, raportin përmbledhës për veprimtarinë minerare të subjekteve të pajisura me lejet minerare të kërkimit-zbulimit –shfrytëzimit për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysëm të çmuara, i cili duhet të përmbajë të dhëna për:
 - i. realizimin e prodhimit,
 - ii. realizimin e investimeve,
 - iii. vlerën e produkteve të shitura,
 - iv. vlerën punimeve minerare të realizuara,
 - v. vlerën e operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare.
 8. Institucioni i AKBN jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të çdo gjashtëmujori duhet të dorëzojë në METE raportin përmbledhës për veprimtarinë minerare të subjekteve të pajisura me lejet minerare të kërkimit-zbulimit –shfrytëzimit për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysëm të çmuara që duhet të përmbajë të dhëna për:
 - i. respektimin e realizimit të projektit minerar;
 - ii. realizimin e operacioneve e të punimeve minerare dhe depozitimin e mbetjeve minerare;
 - iii. lëvizjen e rezervave minerare;
 - iv. kryerjen e operacioneve minerare, në përputhje me normat e ruajtjes së mjedisit minerar, duke u këshilluar me autoritetet e qeverisjes vendore të zonës minerare;

9. Institucioni i AKBN jo me vonë se 60 ditë pas përfundimit të çdo viti duhet të dorëzojë në METE raportin përmbledhës për veprimtarinë minerare të subjekteve të pajisura me lejet minerare të kërkimit-zbulimit –shfrytëzimit për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysëm të çmuara, i cili duhet të përmbajë të dhëna për:
- i. realizimin e prodhimit,
 - ii. realizimin e investimeve,
 - iii. vlerën e produkteve të shitura,
 - iv. vlerën punimeve minerare të realizuara
 - v. vlerën e operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare.
 - vi. respektimin e realizimit të projektit minerar;
 - vii. realizimin e operacioneve e të punimeve minerare dhe depozitimin e mbetjeve minerare;
 - viii. lëvizjen e rezervave minerare;
 - ix. kryerjen e operacioneve minerare, në përputhje me normat e ruajtjes së mjedisit minerar, duke u këshilluar me autoritetet e qeverisjes vendore të zonës minerare;
10. Institucioni i AKBN, për çdo rast të mosrespektimit nga subjektet minerare të pikave 1, 2 , 3 dhe 5 të këtij urdhëri, propozon masat administrative në METE.
11. Institucioni i AKBN vlerëson raportin përfundimtar të veprimtarisë minerare të kërkim-zbulim –shfrytëzimit për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysëm të çmuara dhe realizimin e planit të mbylljes dhe planit të rehabilitimit të çdo subjekti minerar dhe i paraqet për miratim Ministrin vlerësimin e tij në zbatim të kërkesave të Ligjit Nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”.
12. Institucioni i AKBN vlerëson dhe miraton vlerat e garancive financiare vjetore për realizimin e planit të investimit dhe planit të rehabilitimit progresiv e përfundimtar të mjedisit jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e paraqitjes së tyre. Tejkalimi i këtij afati i konsideron këto vlera të miratuara.
13. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet institucioni i AKBN dhe Drejtoria Përgjegjëse në METE që trajton problematikat e lejeve minerare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

NASIP NAÇO



ANEKSI Nr.1

Formati i informacionit tremujor, për veprimtarinë minerare që dorëzohet në AKBN nga zotëruesi i lejes minerare të kërkim-zbulim-shfrytëzimit për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysëm të çmuara

1. Periudha raportuese

a. Tremujori i viti

2. Të dhëna mbi zotëruesin e lejes minerare

- a. Emri i subjektit sipas QKR:
- b. Identifikimi i lejes minerare: Leje Minerare kërkim-zbulim-shfrytëzimi për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysëm të çmuara **Nr....., Datë...../...../.....**
- c. Emri dhe mbiemri i zotëruesit të lejes:
- d. Lloji i mineralit për të cilin është dhënë leja:
- e. Adresa e selisë së subjektit:
- f. Emri dhe mbiemri i administratorit:
- g. Nr. telefonit /faksit:
- h. Emërtimi i njësisë vendore ku kryhet aktiviteti:
- i. Forma e veprimtarisë minerare (nëntokë ose sipërfaqe):
- j. Emri dhe mbiemri i drejtuesit teknik:
- k. Data e përfundimit të licencës profesionale së drejtuesit teknik:

3. Format i tabelës informuese tremujore:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Parashikimi	Realizimi	%
1	Realizimi i Prodhimit	ton/m³			
<i>a</i>	<i>Produkte minerare në total</i>	<i>ton/m³</i>			
<i>b</i>	<i>Prodhim minerali sipas produkteve</i>				
b1	Sasia e produktit të 1	ton/m ³			
b2	cilësia	%			
b3	Sasia e produktit të 2	ton/m ³			
b4	cilësia	%			
b5	Sasia e produktit të 3	ton/m ³			
b6	cilësia	%			
b7	.etj.....	ton/m ³			
b8	%			
<i>c</i>	<i>Produkte të përpunuara</i>				
c1	Sasia	ton/m ³			
c1	cilësia	%			
2	Realizimi i Investimeve dhe punimeve gjeologo-minerare				
<i>a</i>	<i>Vlera totale e investimeve (b+c+ç)</i>	<i>lek</i>			
a1	Kapitale	lek			
a2	Përgatitore	lek			
<i>b</i>	<i>Punime gjeologjike</i>	<i>lek</i>			
b1	Rilevim gjeologjik, harta 1:25000				
b2	Rilevim gjeofizik, harta 1:25000				
b3	Rilevim gjeokimik, harta 1:25000				

	b4	Marshute - prerje, të shkalleve nga 1:25000 deri Në shkallën 1:1000			
	b5	kanale	ml		
	b6	puseza	ml		
	b7	shpime kërkim zbulimi	ml		
	b8	galeri	ml		
	b9	.etj.....		
	b10		
	c	Makineri, pajisje, Ndërtim, montime	lek		
	ç	Punime minerare	lek		
	ç1	Galeri	ml		
	ç2	Shpime	ml		
	ç3	Shtrim shinash	ml		
	ç4	Punime ajrimi	lek		
	ç5	Zbulim dheu	Ton/m ³		
	ç6	.etj.....		
	ç7		
3		Vlera e produkteve të shitura			
	a	Vlera e produkteve minerare të shitura në total	lek		
	a1	Vlera në lek e produkteve të shitura Në vend	lek		
	a2	Çmimi mesatar i shitjes gjatë periudhës tremujore	Lek/ton/m ³		
	a3	Vlera në lek/USD e produkteve të shitura Në eksport	lek		
	a4	Çmimi mesatar i shitjes gjatë periudhës tremujore	USD/ton/m ³		
4		Rehabilitim mjedisi			
	a	Vlera në lek e veprimeve për rehabilitimin e mjedisit	lek		
	b	Operacionet e kryera për rehabilitim mjedisor			
	b1	Pyllëzim	m ²		
	b2	Mbushje dheu	m ³		
	b3	Riparim sipërfaqe	m ²		
	b4	Kanalizime	ml		
	b5	Etj.....			
5		Menaxhim i mbetjeve	lek		
	a	Vlera në lek e veprimeve për menaxhimin e mbetjeve	lek		
	b	Operacionet e kryera për menaxhimin e mbetjeve			
	b1	Sipërfaqe depozitim mbetjesh	m ²		
	b2	Mbushje dheu për diga	m ³		
	b3	Trajtim ujërash	m ³		
	b4	Kanalizime	ml		
	b5	Etj.....			

6		Numri i fuqisë punëtore	nr			
---	--	-------------------------	----	--	--	--

Shënim : shitjet të shoqërohen me fotokopje të faturave përkatëse

Zotëruesi i lejes minerare të kërkim – zbulim - shfrytëzimit

Emër Mbiemër, Firma

Vula,

Vendi dhe data

ANEKSI Nr.2

Formati i informacionit vjetor, për veprimtarinë minerare që dorëzohet në AKBN nga zotëruesi i lejes minerare të kërkim-zbulim-shfrytëzimit për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysëm të çmuara

1. Raporti financiar e teknik duhet të dorëzohet pranë AKBN, çdo vit jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga përfundimi i vitit përkatës të llogaritur me datën efektive dhe duhet të përmbajë një raport informativ mbi realizimin e prodhimit, investimeve, vlerën e produkteve të shitura, punimeve minerare të realizuara, operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare, në përputhje me detyrimet e tij të lejes minerare dhe planin vjetor të ndarë në kapitujt e mëposhtëm:

- a) Realizimi i prodhimit;
- b) Realizimi i investimeve, të dhëna për vlerën punimeve minerare të realizuara, vlerën e operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare;
- c) Të dhëna për vlerën e produkteve të shitura, taksave të paguara;
- d) Raportin markshederik për lëvizjen e rezervave minerare;
- e) Vlerësimin krahasues për respektimin e realizimit të projektit minerar, realizimin e operacioneve e të punimeve minerare, depozitimin, trajtimin, menaxhimin e mbetjeve minerare dhe rehabilitimin mjedisor në përputhje me normat e ruajtjes së mjedisit minerar;

Në mënyrë më të detajuar për aspektet gjeologjike

- i. Relacion i shkurtër gjeologjik mbi rezultatet e punimeve të kryera;
- ii. Volumet e punimeve sipërfaqësore të kryera si: Rilevim gjeologjik; gjeofizik, gjeokimik, marshute - prerje, të shkalleve nga 1:25000 deri në shkallën 1:1000 të shoqëruara me hartat dhe prerjet gjeologjike përkatëse;
- iii. Volumet e punimeve minerare të kryera si: kanale, puseza, zhveshje gjeologjike, shpime kërkim zbulimi, galeri të shoqëruar me dokumentime gjeologjike, skica, foto, planimetri të punimeve të kryera, prerje kërkim zbulimi në shkallë 1:100 -1:1000;
- iv. Sasia e provave të marra për studime kërkim-zbulimi minerar, si dhe rezultatet e analizave të kryera në rajonin e licencuar;
- v. Informacion mbi punimet e kryera për rehabilitimin e mjedisit si mbyllje tanshesh, puseza, mbyllje galerish, mbjellje pemësh etj;

Në mënyrë më të detajuar për aspektet minerare

- i. Frontet ku është zhvilluar veprimtaria minerare dhe çdo veprimtari tjetër që lidhet me detyrimet e lejes minerare dhe programit vjetor;
- ii. Raportin markshederik për lëvizjen e rezervave të shoqëruar me planimetritë e punimeve të kryera, prerjet në shkallë 1:100 -1:1000
- iii. Gjendjen e punimeve minerare të shoqëruar me skica, foto, planimetri, prerje në shkallë 1:100 -1:1000;
- iv. Veprimtaria minerare për menaxhimin e trajtimin e mbetjeve dhe rigjenerimin e mjedisit;
- v. Shpenzimet financiare në leke mbi punimet e kryera, sipas zërave dhe në total, krahasimi i tyre me realizimin e programit të investimit, të përcaktuar në projektin e zhvillimit të veprimtarisë minerare.
- vi. Llogaritjet e realizimit të programit të investimit për të vlerësuar garancinë e realizimit të programit të investimit

- vii. Informacion për respektimin e kërkesave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së shëndetit të punonjësve;
 - viii. Informacion për plotësimin e kërkesave të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse;
 - ix. Shpjegime dhe argumente mbi mosrealizimet eventuale të programit vjetor për periudhën raportuese.
 - x. Çdo shpjegim tjetër që zotëruesi i lejes minerare e gjykon të arsyeshme t'ia beje të njohur strukturës përgjegjëse
2. Në përfundim të pjesës narrative Raporti financiar e teknik duhet të përmbajë gjithashtu katër tabelat e përshkruara me poshtë:

Tabelat përmbledhëse të veprimtarisë minerare vjetore të subjektit minerar të pajisur me lejen minerare të kërkim-zbulim-shfrytëzimit për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysëm të çmuara Nr....., Datë/...../.....

1. Periudha raportuese

- a. Periudha vjetore/...../..... -/...../.....

2. Të dhëna mbi zotëruesin e lejes minerare

- a. Emri i subjektit sipas QKR:
- b. Identifikimi i lejes minerare: Leje Minerare kërkim-zbulim-shfrytëzimi për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysëm të çmuara Nr....., Datë...../...../.....
- c. Emri dhe mbiemri i zotëruesit të lejes:
- d. Lloji i mineralit për të cilin është dhënë leja:
- e. Adresa e selisë së subjektit:
- f. Emri dhe mbiemri i administratorit:
- g. Nr.telefonit /faksit:
- h. Emërtimi i njësisë vendore ku kryhet aktiviteti:
- i. Forma e veprimtarisë minerare (nëntokë ose sipërfaqe):
- j. Emri dhe mbiemri i drejtuesit teknik:
- k. Data e përfundimit të licencës profesionale së drejtuesit teknik:

3. Formati i tabelës informuese vjetore:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Parashikimi					Realizimi					%
			Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Viti	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Viti	
1	Realizimi i Prodhimit	ton/m³											
	a <i>Produkte minerare në total</i>	<i>ton/m³</i>											
	b <i>Prodhim minerali sipas produkteve</i>												
	b1 Sasia e produktit të 1	ton/m ³											
	b2 cilësia	%											
	b3 Sasia e produktit të 2	ton/m ³											
	b4 cilësia	%											
	b5 Sasia e produktit të 3	ton/m ³											
	b6 cilësia	%											
	b7 .etj.....	ton/m ³											
	b8	%											
	c <i>Produkte të përpunuara</i>												
	c1 Sasia	ton/m ³											
	c1 cilësia	%											
2	Realizimi i Investimeve dhe punimeve gjeologo-minerare												
	a <i>Vlera totale e investimeve (b+c+ç)</i>	<i>lek</i>											
	a1 Kapitale	lek											
	a2 Përgatitore	lek											
	b <i>Punime gjeologjike</i>	<i>lek</i>											
	b1 Rilevim gjeologjik, harta 1:25000												
	b2 Rilevim gjeofizik, harta 1:25000												
	b3 Rilevim gjeokimik, harta 1:25000												
	b4 Marshute - prerje, të shkalleve nga 1:25000 deri në shkallën 1:1000												
	b5 kanale	ml											
	b6 puseza	ml											
	b7 shpime kërkim zbulimi	ml											
	b8 galeri	ml											

	b9	.etj.....																
	b10																
	c	Makineri, pajisje, Ndërtim, montime , etj.	lek																
	ç	Punime minerare	lek																
	ç1	Galeri	ml																
	ç2	Shpime	ml																
	ç3	Shtrim shinash	ml																
	ç4	Punime ajrimi	lek																
	ç5	Zbulim dheu	Ton/m ³																
	ç6	.etj.....																
	ç7																
3		Vlera e produkteve të shitura																	
	a	Vlera e produkteve minerare të shitura në total	lek																
	a1	Vlera në lek e produkteve të shitura në vend	lek																
	a2	Çmimi mesatar i shitjes gjatë periudhës tremujore	Lek/ton/m ³																
	a3	Vlera në lek/USD e produkteve të shitura në eksport	lek																
	a4	Çmimi mesatar i shitjes gjatë periudhës tremujore	USD/ton/m ³																
4		Rehabilitim mjedisi																	
	a	Vlera në lek e veprimeve për rehabilitimin e mjedisit	lek																
	b	Operacionet e kryera për rehabilitim mjedisor																	
	b1	Pyllëzim	m ²																
	b2	Mbushje dheu	m ³																
	b3	Riparim sipërfaqe	m ²																
	b4	Kanalizime	ml																
	b5	Etj.....																	
5		Menaxhim i mbetjeve	lek																
	a	Vlera në lek e veprimeve për menaxhimin e mbetjeve	lek																
	b	Operacionet e kryera për menaxhimin e mbetjeve																	
	b1	Sipërfaqe depozitim mbetjesh	m ²																
	b2	Mbushje dheu për diga	m ³																
	b3	Trajtim ujërash	m ³																

	b4	Kanalizime	ml												
	b5	Etj.....													
6		Numri i fuqisë punëtore	nr												
7		<i>Pagesat e taksave lokale</i>	<i>lek</i>												
8		<i>Pagesa e taksave qendrore</i>	<i>lek</i>												
9		<i>Pagesa e rentës minerare</i>	<i>lek</i>												
10		<i>Pagesa për sipërfaqen e zonës së lejuar minerare</i>	<i>lek</i>												
11		<i>Pagesat për sigurimin e jetës së punëtoreve</i>	<i>lek</i>												
12		<i>Pagesat e sigurimeve shoqërore</i>	<i>lek</i>												
13		<i>Pagesa e garancisë së planit të investimeve</i>	<i>lek</i>												
14		<i>Pagesa e garancisë së planit të rehabilitimit të mjedisit</i>	<i>lek</i>												

Shënim : shitjet, pagesat të shoqërohen me fotokopje të faturave përkatëse

4. Tabela e gjendjes dhe lëvizjes së rezervave.

Nr	Lloji dhe kategoria e rezervave	Gjendja e rezervave Në fillim të vitit raportues.../.../.....-...../.../.....		Konsumi i rezervave gjatë vitit .../.../.....-/.../.....				Gjendja e rezervave në fund të vitit raportues	
				Planifikuar		Realizuar			
		Sasi (ton)	Cilësi (%)	Sasi (ton)	Cilësi (%)	Sasi (ton)	Cilësi (%)	Sasi (ton)	Cilësi (%)
1	A (ton)								
2	B (ton)								
3	C1 (ton)								
4	C2 (ton)								
	Total, nga këto:								
a	Të përgatitura (ton)								
b	Të gatshme (ton)								

Zotëruesi i lejes minerare të kërkim – zbulim - shfrytëzimit

Emër Mbiemër, Firma

Vula,

Vendi dhe data

ANEKSI Nr.3

Formati i planit vjetor të punës, për veprimtarinë minerare që dorëzohet në AKBN nga zotëruesi i lejes minerare të kërkim-zbulim-shfrytëzimit për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysëm të çmuara

1. Plani vjetor i veprimtarisë minerare për vitin pasardhës duhet të dorëzohet pranë AKBN çdo vit 30 (tridhjetë) ditë kalendarike përpara përfundimit të vitit përkatës të llogaritur me datën efektive të lejes minerare dhe duhet të përmbajë në mënyre të specifikuar dhe të detajuar në tremujore, kapacitetet e prodhimit, vlerën e investimeve dhe operacionet që do të kryhen nga ana e subjektit gjatë veprimtarisë së tij minerare një vjeçare.
2. Subjektet minerare, në kapitull të veçantë, duhet të paraqesin vlerësimin e tyre për vlerat e garancisë për realizimin e planit të investimit dhe garancisë për realizimin e planit të rehabilitimit në përputhje dhe të harmonizuar në kohë me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në lejen minerare
3. Institucioni i AKBN, jo me vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e paraqitjes së planit vjetor minierar miraton vlerat e garancisë për realizimin e planit të investimit dhe garancisë për realizimin e planit të rehabilitimit. Në rast mosmiratimi, AKBN e njofton zotëruesin e lejes minerare për arsyet e këtij mosmiratimi. Nëse kjo përgjigje nuk kthehet brenda këtij afati, plani dhe vlerat e garancive quhen të miratuara.
4. Plani vjetor i veprimtarisë minerare duhet të bashkëshoqërohet me dokumentet e mëposhtme teknike:

Për veprimtarinë e kërkim-zbulimit

- i. Rilevim gjeologjik, gjeofizik, gjeokimik, marshute-prerje të shkalleve nga 1:25000 deri Në shkallën 1:1000, të shoqëruara me hartat përkatëse;
- ii. Punimet minerare që do të kryhen si: kanale, puse, zhveshje, shpime, galeri të shoqëruar me dokumentime, skica, planimetri, prerje në shkallë 1:500 dhe sasia e provave që do të merren, sipas llojeve të analizave;
- iii. Operacionet e punës që do të kryhen për rehabilitimin e mjedisit, së bashku me shpenzimet financiare në lekë për realizimin e projektit të kërkim zbulimit, sipas zërave dhe në total.

Për veprimtarinë e shfrytëzimit

- i. Hartën gjeologo topografike të minierës Shkalla 1:500 ose 1:1000;
 - ii. Planimetrinë e Përgjithshme të minierës me punimet e hapjes, të azhurnuar deri në fund të periudhës raportuese, Planimetritë e horizonteve, Profilet kryesore, Projektioni vertikal, ku me ngjyra të ndryshme të shënohen: punimet e planifikuara dhe ato të kryera në shkallën 1:200 ose 1:500;
 - iii. Pasaportën e shfrytëzimit
 - iv. Pasaportat e punimeve kryesore
 - v. Skemën principale hapësinore të ajrimit, ku të shënohen rrymat e hyrjes dhe daljes së ajrit.
 - vi. Sheshet e depozitimit të sterileve e mbetjeve , në shkallën 1:200 ose 1:500
 - vii. Masat e programuara për rehabilitimin progresiv dhe përfundimtar të mjedisit në shkallën 1:200 ose 1:500
5. Plani vjetor i veprimtarisë minerare duhet të përmbajë tabelat e mëposhtme:

1. Formati i tabelës së planit vjetor mineralar:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Parashikimi				
			Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Viti
1	Parashikimi i Prodhimit	ton/m³					
	<i>a</i> Produkte minerare në total	ton/m³					
	<i>b</i> Prodhim minerali sipas produkteve						
	b1 Sasia e produktit të 1	ton/m ³					
	b2 cilësia	%					
	b3 Sasia e produktit të 2	ton/m ³					
	b4 cilësia	%					
	b5 Sasia e produktit të 3	ton/m ³					
	b6 cilësia	%					
	b7 .etj.....	ton/m ³					
	b8	%					
	<i>c</i> Produkte të përpunuara						
	c1 Sasia	ton/m ³					
	c1 cilësia	%					
2	Parashikimi i Investimeve dhe punimeve gjeologo-minerare						
	<i>a</i> Vlera totale e investimeve (b+c+ç)	lek					
	a1 Kapitale	lek					
	a2 Përgatitore	lek					
	<i>b</i> Punime gjeologjike	lek					
	b1 Rilevim gjeologjik, harta 1:25000						
	b2 Rilevim gjeofizik, harta 1:25000						
	b3 Rilevim gjeokimik, harta 1:25000						
	b4 Marshute - prerje, të shkalleve nga 1:25000 deri në shkallën 1:1000						
	b5 kanale	ml					
	b6 puseza	ml					
	b7 shpime kërkim zbulimi	ml					
	b8 galeri	ml					
	b9 .etj.....					
	b10					
	<i>c</i> Makineri, pajisje, Ndërtim, montime , etj.	lek					

	ç	<i>Punime minerare</i>	<i>lek</i>						
	ç1	Galeri	ml						
	ç2	Shpime	ml						
	ç3	Shtrim shinash	ml						
	ç4	Punime ajrimi	lek						
	ç5	Zbulim dheu	Ton/m ³						
	ç6	.etj.....						
	ç7						
3		Vlera e garancisë financiare për realizimin e planit të investimeve	lek						
4		Parashikimi i të ardhurave	lek						
5		Operacionet e parashikuara për Rehabilitim progresiv dhe përfundimtar të mjedisit							
	<i>a</i>	<i>Vlera Në lek e veprimeve të parashikuara për rehabilitimin e mjedisit</i>	<i>lek</i>						
	<i>b</i>	<i>Operacionet e parashikuara për rehabilitim progresiv dhe përfundimtar të mjedisit</i>							
	b1	Pyllëzim	m ²						
	b2	Mbushje dheu	m ³						
	b3	Riparim sipërfaqe	m ²						
	b4	Kanalizime	ml						
	b5	Etj.....							
6		Vlera e parashikuar për menaxhimin e mbetjeve	lek						
	<i>a</i>	<i>Vlera në lek e veprimeve të parashikuara për menaxhimin e mbetjeve</i>	<i>lek</i>						
	<i>b</i>	<i>Operacionet e parashikuara për menaxhimin e mbetjeve</i>							
	b1	Sipërfaqe depozitim mbetjesh	m ²						
	b2	Mbushje dheu për diga	m ³						
	b3	Trajtim ujërash	m ³						
	b4	Kanalizime	ml						
	b5	Etj.....							
7		Numri i fuqisë punëtore që parashikohet	nr						

8		<i>Vlerësimi i Pagesës për garancinë e planit të investimeve</i>	<i>lek</i>					
9		<i>Vlerësimi i Pagesës për garancinë e planit të rehabilitimit të mjedisit</i>	<i>lek</i>					

2. Tabela e gjendjes dhe lëvizjes së rezervave.

Nr	Lloji dhe kategoria e rezervave	Gjendja e rezervave		Konsumi i planifikuar i rezervave gjatë vitit .../.../.....-...../...../.....			
		Në fillim të vitit raportues.../.../.....-...../.../.....		Planifikuar		Realizuar	
		Sasi (ton)	Cilësi (%)	Sasi (ton)	Cilësi (%)	Sasi (ton)	Cilësi (%)
1	A (ton)						
2	B (ton)						
3	C1 (ton)						
4	C2 (ton)						
	Total, nga këto:						
a	Të përgatitura (ton)						
b	Të gatshme (ton)						

Inxhinieri i licencuar Topograf ose Marshejder
 Inxhinieri i licencuar Gjeolog
 Inxhinieri i licencuar Minerar
 Inxhinieri i licencuar Pasurues (kur ka objekte përpunimi)
 Drejtuesi Teknik

Emër Mbiemër Nr. Licencës Firma
 Emër Mbiemër Nr. Licencës Firma
 Emër Mbiemër Nr. Licencës Firma
 Emër Mbiemër Nr. Licencës Firma
 Emër Mbiemër Nr. Licencës Firma

Zotëruesi i lejes minerare të kërkim – zbulim - shfrytëzimit

Emër Mbiemër, Firma
 Vula,
 Vendi dhe data

ANEKSI Nr.4

Formati i Raportit Përfundimtar, për veprimtarinë minerare që dorëzohet në AKBN nga zotëruesi i lejes minerare të kërkim-zbulim-shfrytëzimit për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysëm të çmuara

1. Raporti Përfundimtar duhet të dorëzohet pranë AKBN për vlerësim, në përfundim të afatit të lejes minerare dhe duhet të përmbajë një raport të detajuar informativ mbi realizimin e prodhimit, investimeve, vlerën e produkteve të shitura, punimeve minerare të realizuara, shfrytëzimin e rezervave dhe gjendjen e rezervave të mbetura, operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare, dhe situatën përfundimtare mjedisore pas realizimit të rehabilitimit në përputhje me detyrimet e tij të lejes minerare dhe planin e veprimtarisë minerare të ndarë në kapitujt e mëposhtëm:

- f) Realizimi i prodhimit gjatë periudhës së lejes minerare;
- g) Realizimi i investimeve vjetore dhe në total, të dhëna për vlerën e punimeve minerare të realizuara, vlerën e operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare;
- h) Të dhëna për vlerën e produkteve të shitura, taksave të paguara;
- i) Raportin markshederik për lëvizjen e rezervave minerare dhe gjendjen përfundimtare të tyre;
- j) Vlerësimin krahasues për respektimin e realizimit të projektit minerar, realizimin e operacioneve e të punimeve minerare, depozitimin, trajtimin, menaxhimin e mbetjeve minerare dhe rehabilitimin mjedisor në përputhje me normat e ruajtjes së mjedisit minerar;
- k) Raportin vlerësues për rehabilitimin përfundimtar të mjedisit dhe depozitimit të mbetjeve minerare së bashku me masat që propozohen për monitorimin post minerar.

Në mënyrë më të detajuar për aspektet gjeologjike

- i. Relacion i plote gjeologjik, që përmban Rilevim gjeologjik; gjeofizik, gjeokimik, marshute - prerje, në shkallën 1:1000, të shoqëruara me hartat dhe prerjet gjeologjike përkatëse;

Në mënyrë më të detajuar për aspektet minerare

- i. Frontet ku është zhvilluar veprimtaria minerare dhe çdo veprimtari tjetër që lidhet me detyrimet e lejes minerare;
 - ii. Raportin markshederik për lëvizjen e rezervave të shoqëruar me planimetritë e punimeve, prerjet në shkallë 1:100 -1:1000 dhe gjendjen përfundimtare të rezervave;
 - iii. Gjendjen e punimeve minerare të shoqëruar me skica, foto, planimetri, prerje në shkallë 1:100 -1:1000 dhe propozimet përkatëse për monitorim postminerar;
 - iv. Përshkrim të aktiviteteve për menaxhimin e trajtimin e mbetjeve dhe rigjenerimin e mjedisit;
 - v. Vlerën vjetore dhe totale të investimit të realizuar
 - vi. Vlerën vjetore dhe totale të prodhimit të realizuar
2. Në përfundim të pjesës narrative Raporti financiar e teknik duhet të përmbajë gjithashtu tabelat e përshkruara me poshtë:

Tabelat përfundimtare e veprimtarisë minerare të subjektit minerar të pajisur me lejen minerare të kërkim-zbulim-shfrytëzimit për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysëm të çmuara Nr....., Datë/...../.....

1. Të dhëna mbi zotëruesin e lejes minerare

- a) Emri i subjektit sipas QKR:
- b) Identifikimi i lejes minerare: Leje Minerare kërkim-zbulim-shfrytëzimi për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysëm të çmuara **Nr....., Datë...../...../.....**
- c) Emri dhe mbiemri i zotëruesit të lejes:
- d) Nr.telefonit /faksit:
- e) Lloji i mineralit për të cilin është dhënë leja:
- f) Emërtimi i njësisë vendore ku është kryer aktiviteti:
- g) Forma e veprimtarisë minerare (nëntokë ose sipërfaqe):
- h) Emri dhe mbiemri i drejtuesit teknik (ose drejtuesve teknik që mund të jene ndryshuar gjatë periudhës së lejes):

2. Formati i tabelës përfundimtare:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Vitet											% Në raport me parashikimin e planit të veprimtarisë minerare	
			1	2	3	Totali			
1	Realizimi i Prodhimit	ton/m ³													
	<i>a</i> <i>Produkte minerare në total</i>	ton/m ³													
	a1 Sasia	ton/m ³													
	A2 cilësia	%													
	<i>b</i> <i>Produkte të përpunuara në total</i>	ton/m ³													
	b1 Sasia	ton/m ³													
	B2 cilësia	%													
2	Realizimi i Investimeve në total	lek													
3	Makineri, pajisje, Ndërtim, montime , etj.	lek													
4	Vlera e produkteve të shitura në total	lek													
5	Vlera në lek/USD e produkteve të shitura Në eksport	Lek/USD													
6	Vlera në lek e veprimeve për rehabilitimin e mjedisit	lek													
7	Vlera në lek e veprimeve për mbylljen e objekteve minerare	lek													
8	Vlera në lek e veprimeve për menaxhimin e mbetjeve	lek													
9	Sipërfaqe deponimit mbetjesh	m ²													
10	Numri i fuqisë punëtore	nr													
11	Pagesat e taksave në total	lek													

12		Pagesa e rentës minerare Në total	lek															
13		Pagesa e garancisë së planit të investimeve	lek															
14		Pagesa e garancisë së planit të rehabilitimit të mjedisit	lek															

3. Tabela e gjendjes dhe lëvizjes së rezervave.

Nr	Lloji dhe kategoria e rezervave	Gjendja e rezervave Në fillim të veprimtarisë minerare .../.../.....		Konsumi i rezervave gjatë periudhës së lejes minerare .../.../.....-.../.../.....				Gjendja e rezervave në fund të periudhës së lejes minerare	
				Planifikuar		Realizuar			
		Sasi (ton)	Cilësi (%)	Sasi (ton)	Cilësi (%)	Sasi (ton)	Cilësi (%)	Sasi (ton)	Cilësi (%)
1	A (ton)								
2	B (ton)								
3	C1 (ton)								
4	C2 (ton)								
	Total, nga këto:								
a	Të përgatitura (ton)								
b	Të gatshme (ton)								

Zotëruesi i lejes minerare të kërkim – zbulim - shfrytëzimit

Emër Mbiemër, Firma

Vula,

Vendi dhe data